



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1635/2 Prot.

Tiranë, më 18 / 12 / 2018

V E N D I M

Nr. 253 , Datë 18 / 12 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 180, datë 21.11.2018, të paraqitur nga R.Sh kundër Zyrës Arsimore Malësi e Madhe në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga R.Sh, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se me Vendimin nr.1, datë 01.03.2017 të Drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Prekë Gjoni” Bajzë, është larguar nga puna si mësuese në ciklin e arsimit parashkollor dhe nuk është pranuar përsëri në punë edhe pse figuron e renditur në vend të parë, në portalin “Mësues për Shqipërinë” në profilin e lëndës Histori. Pas largimit të saj nga puna në pozicionin e saj është emëruar një person tjetër mashkull i cili nuk i plotëson kushtet për të punuar në atë pozicion pune, për më tepër që ai person është i afërm i drejtorit të shkollës “Prekë Gjoni” Bajzë, ndaj të cilit R.Sh ka bërë një kallëzim penal për ngacim seksual, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale lidhur me periudhën kur kanë ndodhur ngjarjet, veprimet ankuese dhe kundërshtuese të ankueses dhe periudhën kur ka kërkuar të punësohet si mësuese.

- Për këtë arsye, me e-mail-et datë 23.11.2018 dhe 26.11.2018, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankueses të dërgojë shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Vendimin e gjykatës për largimin nga puna.
 - Kopje shkresës drejtuar prokurorisë në lidhje me padinë për ngacim seksual.

- Kopje të kërkesës për tu punësuar si mësuese gjatë vitit 2018 dhe përgjigjës së dhënë nga Zyra Arsimore Malësi e Madhe.
 - Emrin dhe vendin e punës të mësuesit/ve që është punësuar gjatë vitit 2018 për të cilin pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, R.Sh me e-mail-in datë 23.11.2018 ka bashkëngjitur përgjigjen e dërguar nga zyraebashkëqeverisjes@shqiperiaqeduam.al, lidhur me ankesën e saj.
 - Me shkresën e administruar pranë Komisionerit nr.1635/1 prot, datë 03.12.2018, ankuesja ka dërguar dokumentet si më poshtë: - Procesverbal për kallëzimin e veprës penale, datë 27.02.2017. – Vendimin datë 28.04.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. - Kërkesën për dokumentacion datë 12.04.2018 drejtuar ZA Malësi e Madhe dhe shkresës nr.93, datë 19.04.2018, Kthim Përgjigje nga ZA Malësi e Madhe. – Kopje të renditjes së portalit “Mësues për Shqipërinë”. - Vendimin nr.1087 (4725), datë 10.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Bazuar në deklaratimet, parashtrimet dhe dokumentet e depozituara nga subjekti ankues pranë Zyrës së KMD-së, Komisioneri, konstaton se:

- Ankuesja ka patur dijeni për largimin nga puna që në datë 01.03.2017, periudhë kur është vënë në dijeni të Vendimit nr.1, datë 01.03.2017, për largimin nga puna dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, për mosparaqitje në punë për një kohë shumë të gjatë.
- Po ashtu, referuar dokumentacionit të depozituar në dosje rezulton se në datë 27.02.2017, R.Sh ka rregjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kallëzim e veprës penale të shqetësimit seksual ndaj drejtorit të Shkollës 9-vjeçare, G.D, për një ngjarje të ndodhur në periudhën, Nëntor 2014. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër pas verifikimit të provave dhe fakteve me vendimin datë 28.04.2017 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 490, datë 03.03.2017 të bërë nga R.Sh.
- Gjithashtu, referuar dokumentacionit të depozituar nga ankuesja, rezulton se pretendimet që rrjedhin nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, subjekti ankues i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin 1087, datë 10.10.2018 ka vendosur konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënieve të punës duke detyruar palën e paditur, Zyra Arsimore Malësi e Madhe t'i paguajë paditëses R.Sh dëmshpërblim. Vendimi nuk ka marrë formë të prerë.
- Pra, **subjekti ankues ka marrë dijeni për largimin nga puna** (për të cilin pretendon diskriminim) **minimalisht që në datë 01.03.2017, ndërkohë që ankesën e ka**

paraqitur pranë zyrës së Komisionerit më datë 21.11.2018, pra më vonë se një vit nga marrja dijani.

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt”*,

ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Bazuar në formularin e ankesës nr. 180, datë 21.11.2018, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të saj, Komisioneri vlerëson se, R.Sh është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese nga ana e Zyrës Arsimore Malësi e Madhe, që në datë 01.03.2017, periudhë kur R.Sh është vënë në dijeni për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket pretendimit për mosmarrjen në punë si mësuese e renditur e para në portalin “Mësues për Shqipërinë” në lëndën Histori, Komisioneri vëren se, megjithëse është kërkuar informacion dhe dokumentacion nga Komisioneri, ankuesja nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar se mosmarrja në punë e ankueses si mësuese është bërë për shkak të gjinisë së saj.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” citon shprehimisht se: ankesa nuk pranohet nëse “*nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetimi*”, çështja e parashtruar nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “*Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale*”, 2: “*Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale*”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje*”, ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç,dh dhe nenin 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së R.Sh, për shkak se është jashtë afateve të parashikuara në dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI